



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 406/1 Prot.

Tiranë, më 03 / 03 / 2025

V E N D I M

Nr. 47, Datë 03 / 03 / 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 257, datë 24.12.2024, e Znj. K. Sh., në cilësinë e përfaqësueses së djalit të saj K. N., kundër Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Korçë, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon: “*Quhem K. Sh. Në muajin tetor kam dorëzuar dokumentet pranë shkollës “Naim Frashëri”, për marrjen e bursës në bazë të VKM-së 666, për fëmijën tim, i cili është person me aftësi të kufizuara. Fëmija im është në klasën e 8-të. Për shkak të sëmundjes që ka nuk është frekuentues i rregullt në shkollë (pasi djali bën dhe terapi). Jetoj në kushte të vështira ekonomike-sociale. Në muajin dhjetor janë shpallur listat e përfituesve, por emri i djalit tim nuk ishte. Kam kërkuar informacion në institucionin përkatës pranë Bashkisë Korçë, por ata më thonë që për ju nuk kemi dokumente, ndërkohë që drejtoria e shkollës më thotë që janë dorëzuar. Për këtë arsye kam dërguar dokumentet përsëri pranë institucionit të Bashkisë, por ato nuk janë pranuar dhe nuk më është dhënë asnjë shpjegim. Për këtë arsye, ju drejtohem ju si institucion për të gjetur një zgjidhje”.*

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e

diskriminimit të tij nga ana e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Korçë, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike, si dhe për marrjen e bursës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr.1706/1, datë 27.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Bashkinë Korçë, Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, Shkollën 9-Vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me shkresën nr.2 prot., datë 06.01.2025, administruar pranë Komisionerit me nr. 26 prot., datë 07.01.2025, Shkolla 9-Vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë në mes të tjerash informoi Komisionerin se:

Djali i zonjës, K. D. N., është nxënës i shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë, dhe aktualisht vazhdon klasën e tetë, të cilën nuk e vijon rregullisht (bazuar në rezultatet e tremujorit të parë 2024-2025).

- Për vitin 2023-2024, nxënësi K.N. ka qenë përfitues i bursës së Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019, dhe Vendimit nr. 511, datë 27.07.2022, “Për ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 666”, i sipërpërmendur, vërtetuar nga listat e dërguara pranë shkollës, nga Drejtoria Mbështetëse e Kopshteve dhe Çerdheve. Nxënësi rezultonte kalues i klasës së shtatë për vitin shkollor 2022-2023.*
- Në datën 28.10.2024, prindi ka marrë vërtetimin shkollor me nr. prot. 224 dhe është rinjohur me mosfrekuentimin e shkollës nga ana e fëmijës së tij.*
- Në po të njëjtën datë është dërguar edhe shkresa përcjellëse me nr. prot. 207, datë 28.10.2024, me emrat e gjithë nxënësve të shkollës në NSHMAS, për vlerësim dokumentacioni.*
- Në listat e përfituesve të bursave, të dërguara në shkollë për vitin 2024-2025, të protokolluara me nr. 288, datë 18.12.2024, nxënësi K. N., nuk rezulton përfitues, pasi dokumentacioni i tij është rikthyer në shkollë pas vlerësimit paraprak të bërë nga Drejtoria Mbështetëse, duke qenë se ai ka rezultuar jokalues për vitin 2023-2024.*

Zonja K. Sh., është njoftuar të paraqitet në shkollë disa herë nga mësuesi kujdestar dhe Drejtoria e shkollës për të njohur situatën e ecursisë së fëmijës së saj në shkollë dhe vijueshmërinë e tij, si dhe për të njohur statusin e djalit pas vlerësimit të dokumentacionit të bursave.

- Pas daljes së listave të përfituesve për këtë vit shkollor, zonja ka kërkuar në shkollë të tërheqë dokumentacionin e dorëzuar, i cili i është vënë në dispozicion.*
- Shkolla është institucioni që asiston nxënësit dhe familjarët në mbledhjen dhe dorëzimin e dokumentacionit në NSHMAS dhe jo në vlerësimin e dokumentacionit dhe kriterëve për bursë.*
- Shkolla ju përcjell dokumentacionin që disponon për nxënësin K. N., lidhur me vlerësimet dhe frekuentimin e shkollës nga ana e tij, për vitet shkollore 2023-2024 dhe 2024-2025.*
- Raporti mjekësor për kryerjen e terapive nga ana e fëmijës, prindi nuk e ka dorëzuar në shkollë, edhe pse i është kërkuar justifikim për mungesat.*
- Nënës së nxënësit i është ofruar asistencë nga shkolla për ta regjistruar në një shkollë të afërt, pranë vendbanimit të tyre, me dëshirën që vijueshmëria në shkollë e nxënësit të mos kushtëzohet, qoftë edhe nga largësia, dhe kjo nuk është pranuar nga ana e saj.*
- Dokumenti përcjellës ndodhet në zyrat e NSHMAS, Korçë, në tabelën përmbledhëse për të gjithë nxënësit e shkollës, jo individual për secilin nxënës.*

Gjithashtu, edhe dokumenti që e përcakton fitues vitin e kaluar, është i pasqyruar për të gjithë nxënësit e shkollës, dhe mund të tërhiqet tek Zyra Juridike e NSHMAS, Korçë.

Me shkresën nr.2 prot., datë 06.01.2025 , administruar pranë Komisionerit me nr. 62 prot., datë 09.01.2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Korçë, ka informuar Komisionerin se:

Për Përcaktimin e "Kuotave financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte, si dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore publike", citojmë se vlerësimi i kriterëve bëhet duke u bazuar në:

- *Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019, me nr. 9488 Prot. datë 15.10.2019, për "Kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte, dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore publike".*
- *Vendimin nr. 511, datë 27.07.2022, me nr. 6642 Prot. datë 29.07.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, për 'Kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore publike'".*

Sipas këtyre dy Vendimeve të Këshillit të Ministrave:

Znj. K. Sh., ka kërkuar bursë për fëmijën e saj, K. N., nxënës në shkollën "Naim Frashëri". Sipas informacionit nga Drejtoria e shkollës, prindi ka dorëzuar dokumentet për të aplikuar për bursë pranë kësaj drejtorie. Shkolla i ka pranuar dokumentet dhe i ka dorëzuar ato pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes.

Nga ana jonë, dokumentacioni i dorëzuar nuk është pranuar pasi nxënësi ka qenë përsëritës për vitin shkollor 2023-2024 dhe të gjitha dokumentet i janë kthyer përsëri shkollës. Mospranimi i dokumenteve është bërë në bazë të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, lidhur me kategoritë që përfitojnë bursë në përputhje me kriteret përkatëse, ku në pikën 3 thuhet: "Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:3/a. Janë ndarë nga trangu familjar.3/b. Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private.3/c. Deklarohen mbetës ose përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalueve".

Rrjedhimisht, për këtë fakt, nxënësi nuk e ka përfituar pagesën e bursës për vitin shkollor 2024-2025.

Përsa i përket kërkesës suaj për informacion në lidhje me faktin nëse nxënësi ka përfituar apo jo bursë vitin e kaluar, shpjegojmë se nxënësi K. N., ka qenë përfitues i bursës për vitin shkollor 2023-2024, bazuar në Vendimin nr. 164, datë 29.12.2023, të Këshillit Bashkiak Korçë, sepse në atë vit shkollor nxënësi nuk ka rezultuar mbetës ose përsëritës dhe ka dorëzuar të gjitha dokumentet që nevojiten për aplikimin për bursë. Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni Vendimet

e Këshillit Bashkiak Korçë për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024 dhe 2024-2025.

- Me shkresën nr. 115 prot., datë 14.01.2025, të Komisionerit, drejtuar ankueses, i janë përcjellë shkresat e institucioneve për të bërë kundërshtimet e saj. Nga ana e ankueses nuk u kthye asnjë përgjigje, edhe pse rezultoi që sipas lajmërim-marrjes të Postës Shqiptare sh.a, Nr. RR 720 710 604 AA, ajo e ka marrë në dorëzim këtë shkresë më datën 14.01.2025.

Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ankueses për trajtimin diskriminues në procedurën e ndjekur për përfitim të bursës për fëmijën e saj, për shkak të gjendjes ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10021/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Procedura dhe dokumentacioni i përfitimit të bursës rregullohet sipas përcaktimeve të VKM-së VKM nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*; të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022.

Nga ana e ankueses na janë vënë në dispozicion në cilësinë e provës:

- Vërtetim nr.224 prot., datë 28.10.2024 i Shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri", Korçë, me anë të cilit vërtetohet se K. N., është nxënëse i klasës së tetë pranë kësaj shkolle për vitin shkollor 2024-2025.

- Çertifikatë e gjendjes familjare e datës 09.10.2024.
- Çertifikatë e personale i fëmijës K. N., e datës 09.10.2024.
- Vërtetim për Aftësinë e Kufizuar për fëmijën K. N., i cili është diagnostikuar me diagnozën “*Epilepsite dhe sindromet epileptike të gjeneralizuara*”.

Sa më sipër, Komisioneri do të shqyrtoi këtë çështje në bazë të shpjegimeve të dhëna nga ankuesja në Formularin e ankesës e saj, dokumentacionit shoqërues si dhe informacionit të dhënë nga Bashkia Korçë me.

Në këtë kuptim, referuar VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike*”; të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, personat që kërkojnë të trajtohen me bursë, duhet të aplikojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar, pranë Institucioneve Arsimore jo më vonë se muaji tetor dhe pranë Këshillit Bashkiak në fund të muajit dhjetor.

Në pikën 2, të këtij vendimi përcaktohet se:

2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

2.1 Kriteri ekonomik:

.....

c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

Referuar provave dhe informacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se ankuesja ka aplikuar për të përfituar bursën për djalë e saj por nuk i plotëson kushtet për të përfituar sipas legjislacionit të sipërcituar, pasi së pari ajo apo bashkëshorti i saj nuk figurojnë si punëkërkuar të papunë nga Zyra Vendore e Punësimit Korçë, gjithashtu nuk rezulton të jetë përfituese e ndonjë skeme ekonomike/sociale, si familje në nevojë.

Në lidhje me pretendimin se jetojnë në kushte të vështira ekonomike-sociale, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas përcaktimeve të nenit 3, të tij, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të vendosura në nenin 11 të këtij ligji.

Në nenin 4, të këtij Ligji, ndër të tjera përcaktohet se:

“Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

.....

c) “Bashki/njësi administrative”, është institucioni nën juridiksionin e të cilit personat përfitues, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar mbështetje me të ardhura monetare ose/dhe në natyrë, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për të kërkuar mbështetje për adresimin e situatës së tyre social-ekonomike drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të punësimit, strehimit;

d) “Familje”, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, të cilët jetojnë në të njëjtën strehë;

e) “Fëmijë”, është çdo person nën moshën 18 vjeç dhe, në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;

.....

k) “Ndihma ekonomike”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

Në kreun II, “Përfituesit e asistencës sociale”, neni 6, i po këtij Ligji, përcakton se: “Asistenca sociale përfshin, por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera, që garantohen nga ky ligj.”

Sipas nenit 7, “Përfituesit e ndihmës ekonomike”, shkronja a, e tij, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.”

Gjithashtu referuar informacionit të dërguar nga Shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, Bashkia Korçë është sqaruar fakti se nxënësi K. N., nuk rezulton përfitues, pasi ai ka rezultuar jokalues për vitin 2023-2024.

Ndërkohë në zbatim të përcaktimeve të bëra në VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”; të ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022, është parashikuar se: 3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

Neni 7 i LMD-së¹, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara gjatë hetimit të ankesës rezultoi se ankuesja nuk plotëson kushtet për të përfutur sipas legjislacionit të sipërcituar, pasi nuk figuron si punëkërkuese e papunë nga Zyra Vendore e Punësimit Korçë dhe nuk rezulton të jetë përfutuese e ndonjë skeme ekonomike/sociale, si familje në nevojë. Gjithashtu fëmija i saj rezulton jokalues për vitin shkollor 2023-2024, kriter i cili është i domosdoshëm për përfitimin e bursës.

Në këtë moment vlen të përmendim dhe faktin se nxënësi K. N., ka qenë përfutues i bursës për vitin shkollor 2023-2024. Për sa kohë aplikimi ka qenë i plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe janë përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara sipas aktit nënligjor, Bashkia Korçë nuk ka pasur asnjë arsye për të mohuar këtë të drejtë.

Për sa kohë që kërkesa e ankueses nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në aktin nënligjor aktual në fuqi, mbi bazën e të cilit është trajtuar kërkesa për përfitimin e bursës për djalin e saj, institucioni ka detyrimin ligjor për të zbatuar këto parashikime dhe për të mos e pranuar kërkesën. Për pasojë, nëse kriteret dhe dokumentacioni i kërkuar nuk janë plotësuar, Bashkia është e detyruar të respektojë kriteret e vendosura për përfitimin e bursave dhe të refuzojë përfitimin, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se fëmija i ankueses nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Korçë.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me trajtimin e rastit të nxënësit K. N., kundër Bashkisë Korçë. Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

¹ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të nxënësit K. N.², nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

² Përfaqësuar nga nëna e tij znj. K. Sh.